



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 52/12

Prishtinë, më 14.03.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj dhe Duda Balje.

Munguan: Muhamet Mustafa dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja , konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme

Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohen njëzëri propozim-amendamentet e grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet e përhershme sipas kompetencës së tyre.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale

Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohen njëzëri propozim-amendamentet e grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale, dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet e përhershme sipas kompetencës së tyre.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave

Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohen njëzëri propozim-amendamentet e grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave, dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet e përhershme sipas kompetencës së tyre.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109

Jelena Bontic, njoftoi se në grupin punuese lidhur me nenin 252 kemi pasur diskutime dhe njëra nga anëtarët e grupit punues që doganieri të ketë të drejtë e arrestimit siq është propozuar me këtë projektligj. Megjithatë ne kemi i lënë siq ka qenë në projektligj që doganierët e caktuar me lejen e drejtorit të përgjithshëm të doganave të ketë të drejtën e arrestimit, ndërkaq për doganierit tjerë, kemi propozuar që të kenë të drejtën vetëm të ndalimit.

Sali Asllanaj, vlerësoj se kemi të bëjmë me një çështje parimore dhe përkundër justifikimeve të dhënë nga Drejtori i Zyrës Ligjore të Ministrisë së Financave se e drejta e arrestimit nga ana doganierit është e rregulluar dhe lejuar në shtetet e BE-së, unë prapë mbaj qëndrime që doganierit të mos gëzojë të drejtën e arrestimit. Është një imazh jo i mirë për doganierin që të ketë të drejtën e arrestimit, kur dihet se arrestimet i bënë policia. Doganieri mund të ndaloj por duhet të dorëzojë personin autoriteteve policore.

Kryetarja, sqaroi se grupi punues në nenin 252 në paragrafin 1 ka sugjeruar të mbetet si në projektligj, që nënkupton se doganierit e autorizuar nga drejtori i përgjithshëm i doganave, do të kenë të drejtën në arrestime sipas këtij ligji. Ndërkaq në paragrafin 2 të këtij neni është propozuar që doganierët tjerë nuk mund të arrestojnë përveç se të ndalojnë personat e caktuar dhe si rezultat është propozuar që fjala arrestim të zëvendësohet me fjalën ndalim.

Naser Osmani, theksoi se oficerët doganore nuk kanë drejt të arrestoj dhe këtë unë e bënë policia. Oficeri doganore e ndalon personin dhe ia dozon policisë por jo të arrestoj.

Lulzim Ismajli, sqaroi se me qëllim të përmbushjes së standardeve evropiane, modernizimin e doganës së Kosovës dhe integrimin bashkë me doganat tjera, e kemi për obligim të krijojmë bazën ligjore ku ofron të drejtën që oficerët doganor të kenë të drejtë për arrestime. Në mungesë të bazës ligjore për arrestim, kemi pasur problem me zgjatjen e procedurave dhe vonesë për arrestimin e personave nga policia. Është rekomandim i Komisionit Evropian që me e fute edhe te drejtën e arrestimit. Nuk është fjala vetëm për arrestime, dhe është fjala për kriminelët e kërkuar që mund të bien në duar të doganierëve dhe nuk do të jetë as e moralshme as profesionale që ta lejon te shkon.

Naser Osmani, pyeti a ka marrëveshje në mes policisë dhe doganave që e autorizon doganierit me ndërmarrë këso veprime, a është doganieri i armatosur?

Lulzim Rafuna, në përgjigjen e parafolësit, theksoi se doganierët janë të armatosur dhe doganat kanë njësitë e armatosura përfshirë njësitë e intelegjencës. Doganieri nuk autorizohet prej policisë po prej prokurorit. Po ashtu sipas kodit të procedurës penale të Kosovës edhe oficeret doganore janë kompetent për zbulimin e veprave penale, për kundër doganës sipas kreut 8 ata kanë të bëjnë vetëm me evazione fiskale dhe

Latif Gashi, theksoi se në grupin punues e kemi propozuar ndalimin në vend të arrestimin, por kemi bërë gabim, pasi që ndalimin e personit e bënë vetëm prokurori dhe përmes vendimit e dërgon personin në qendër të paraburgimit, ndërkaq arrestimi bëhet nga policia. Me qëllim që doganierët të kenë mundësinë e arrestimit të personave të dyshuar për vepra penale duhet të kenë të drejtën e arrestimit.

Xhevdet Neziraj, thekoi e drejta e oficerit doganor për të arrestuar nuk duke me imazh të mirë. Mund ti tekton një doganieri më të ndal, ndoshta nuk të ka simpatik dhe ti vendos prangat. Kam frikën se mund të keqpërdoret kjo nga doganierët.

Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohen njëzëri propozim-amendamentet e grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa (me përjashtim të amendamentit 9) për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet e përhershme sipas kompetencës së tyre.

6. Të ndryshme.

Kryetarja, njoftoi anëtarët se në pajtim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, komisionet parlamentare janë të obliguar që dy muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve të bordeve dhe agjencioneve të pavarura, të njoftojnë Kryetarin e Kuvendit, i cili mëpastaj iu dërgon njoftimin institucioneve përkatëse që janë përgjegjëse për propozimin e kandidatëve të rinj për emërim në Kuvend. Me këtë rast ne duhet të njoftojmë Kryetarin e Kuvendit për skadimin e anëtarëve të bordit të trustit të kursimeve pensionale në fund të muajit prill që të kërkojë nga Komisioni për përzgjedhje i kryesuar nga Guvernatori, të propozojë kandidatë e rinj për emërim nga Kuvendi sipas dispozitave të ligjit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj